



Primitje / Deregizim Primitje / Prizdat Received / Deliverty	10.06	2022	2	viti god year
Organ / Rjeshta Organ / Rjednitca Org / Unit	Nr / Prot Br / Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKINSHICK	3385/2022		116	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.426/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj -Demi anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.426/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja ne adresë banimi në fshatin kundër organit të punësimit Thesari i Kosovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 10.06.2022, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.426/2022 e datës 27.04.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi numër 02/2022 i datës 13.04.2022 dhe Vendimi 10/2022 i datës 21.04.2022 i Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Thesarit të Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Alokime* me numër reference RN00008524 në Thesarin e Kosovës.

Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 02/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN00004012 të ankueses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe rrjedhimisht e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidatëve.



Kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit, ankuesja me datë 15.04.2022 ka parashtruar ankesë të Njësia për Burime Njerëzore e Thesarit të Kosovës. Kjo e fundit me Vendimin me numër 10/2022 të datës 21.04.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesja e pa kënaqur me Vendimin me numër 10/2022 të datës 21.04.2022 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar, me datë 27.04.2022 ka parashtrua ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 05.05.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Thesarin e Kosovës, ndërsa kjo e fundit me datë 17.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2873/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 2451/2022 të datës 27.04.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin Nr. 2718 për verifikimin e të dhënave të aplikuesit të datës 04.03.2022; Vërtetimin me numër 12/1595 të datës 12.04.2022; Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master me numër 01/96 të datës 04.03.2022; Vendimin me Nr.02/2022 të datës 13.04.2022; Vendimin me Nr.10/2022 të datës 21.04.2022; Akt emërimit e datës 01.07.2018; Akt emërimit e datës 01.07.2019; Vendimin me Nr.02-112/02-0024841/21 të datës 19.03.2021; Vërtetimin Nr.13-72/2022 të datës 31.03.2022; Vërtetimin me Nr.13-71/2022 i datës 30.03.2022; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 30.11.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne punë te nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulet dhe profesionale të datës 30.01.2022; Certifikatën me nr. 1763/2022 e datës 31.03.2022; Dokumentin e Identifikimit të ankueses: Vërtetimin e datës 05.04.2022; Certifikatën e datës 15.04.2021; Diplomën me Nr.6367 të datës 05.04.2016; Kërkesën për përgjigje ne ankesë të datës 05.05.2020 me numër te protokollit 2618/2022; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2873/2022 të datës 17.05.2022; Konkursin e datës 14.03.2022; Aplikacionin e datës 01.04.2022 e ankueses së bashku me dosjen e ankueses; Diplomën me Nr.6367 të datës 11.03.2016; Listën e aplikantëve; Aplikacionin e kandidatit të datës 01.04.2022; Akt emërimit e datës 01.12.2012; Diplomën me Nr. 232 të datës 14.11.2012; Diplomën me Nr.1825 të datës 29.03.2006; Dokumentin e identifikimit; Diplomën e datës 24.05.2002; Letër rekomandimin me numër të protokollit 359/10; Leter rekomandimin e datës 07.10.2009; Vërtetimin me numër 31/05 te datës 15.09.2005; Vërtetimin me numër 64/019 të datës 01.11.2019; Vërtetimin e me Nr. 13-116/04-0047659/21 të datës 16.6.2021; Vërtetimin me Nr.13-113/01-0047660/21 të datës 14.06.2021; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 01.12.2020; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune te datës 26.01.2022; Certifikatën 24.09.2021; Certifikatën (datën e pa identifikuar); Certifikatën e datës 08.09.2015; Raportin financiar të datës 18-19.01.2013; Certifikatën e datës 28-29.03.2018; Certifikatën e datës 16.11.2007; Certifikatën e datës 08.12.2010; Certifikatën e datës 28.03.2022; Vërtetimin e datës 23.03.2022; Dokumentin e identifikimit; Aplikacionin e datës 05.04.2022 të kandidatës Akt emërimit e datës 22.07.2015; Diplomën me Nr.271/45-65 të datës 30.07.2019; Diplomën me Nr.310/02-1 të datës 26.11.2012; Diplomën e datës 18.10.2008; Dokumentin e Identifikimit te kandidatës Certifikatën e datës 24.12.2017; Certifikatën e datës 12.04.2017; Certifikatën e datës 12.11.2015; Certifikatën e datës 10.11.2011; Certifikatën e datës 15.04.2011; Certifikatën e datës 28.01.2011; Certifikatën e datës

07.07.2009; Certifikatën e datës 05.08.2011; Referencën e datës 04.03.2015; Referencën e datës 04.03.2015; Letër referencën e datës 28.03.2015; Vërtetimin e datës 27.03.2015; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 07.02.2019; Vërtetimin me Nr.01-116/-0031899/22 të datës 05.04.2022; Certifikatën e datës 06.04.2022; Vërtetimin e datës 08.04.2022; Aplikacionin e kandidatit të datës 29.03.2022; Akt Emërimit e datës 05.01.2015; Diplomën me Nr.75/09 të datës 26.06.2009; Diplomën me Nr. 299 të datës 20.09.2019; Diplomën e datës 25.05.2005; Dokumentin e identifikimit si dhe ID kartelën e kandidatit Certifikatën e datës 23.09.2021; Certifikatën e datës 01.02.2017; Certifikatën e datës 16.03.2016; Certifikatën e datës 23.09.2021; Certifikatën e datës 04.05.2011; Certifikatën e datës 14.12.2012; Vërtetimin me Nr.1060 të datës 04.12.2015; Formularin për vlerësimin e rezultateve ne pune të datës 30.12.2020; Formularin e rezultateve te punës të datës 25.12.2021; Vërtetimin e datës 04.04.2022; Certifikatën e datës 04.04.2022; Vërtetimin me Nr.03.112/07-2923/1 të datës 02.03.2022; Njoftimin për listën e ngushtë me numër të protokollit 109 të datës 13.04.2022; Emalin zyrtar të datës 07.06.2022; Njoftimin me numër të protokollit 127 të datës 21.04.2022; Njoftimin e datës 22.04.2022; Njoftimin për kandidatin fitues 29.04.2022; Emalin e datës 21.04.2022; Emalin e datës 22.04.2022; Emalin e datës 21.04.2022; Emalin e datës 22.04.2022; Emalin e datës 21.04.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuese: **është e pa bazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 14.03.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për *lëvizje brenda kategorisë* për pozitën e punës "*Zyrtar i Lartë për Alokime*" me numër reference RN00008524, në Thesarin e Kosovës. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara:

- **Arsimi i kërkuar:** Diploma e studimeve universitare në Fakultetin *Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diplomën Master të jetë e njëjta apo vazhdim i diplomës Bachelor;*
- **Përvoja e punës:** *së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës se lire të punës.*

Sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesja me datë 01.04.2022 ka aplikuar në konkursin e shpallur për lëvizje brenda kategorisë për pozitën e punës *Zyrtar i Lartë për Alokime* me numër reference RN00008524 në Thesarin e Kosovës, mirëpo Menaxherja e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin numër 02/2022 të datës 13.04.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN00004012 të ankuseses me arsyetimin se e njëjta nuk ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesja nuk posedon arsimin e kërkuar (diplomë të studimeve master) dhe e njëjta nuk është përfshirë në listën e shkurtër të kandidateve. Rrjedhimisht ankuseses me bazë të njëjta i është refuzuar edhe ankesa e parashtruar kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "*Zyrtar i Lartë për Alokime*" sepse e njëjta pretendon se i ka plotësuar kriteret e konkursit dhe për këtë ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme si Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, si dhe Vërtetimin qe dëshmon se ka diplomuar me datë 04.03.2022, dokumente këto të nënshkruara, vulosura dhe protokolluara nga Fakulteti Ekonomik - Universiteti i Prishtinës "*Hasan Prishtina*". Ankuesja thekson se për shkak të

procedurave të brendshme administrative ende nuk është përgatit diploma e studimeve master dhe se nuk ka mundur ta sjell të njëjtën, mirëpo e njëjta konsideron se ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme që vërtetohet se ka përfunduar studimet master me datë 04.03.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankueses ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha së bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesja Janina Shala ka përfunduar studimet themelore me datë 11.03.2016 dhe ka marrë titullin Bachelor për Ekonomik me gjithsej 180 kredi/ECTS, dhe kjo është vërtetuar përmes Diplomës me numër 6367 të datës 05.04.2016 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina". Ndërsa lidhur me përfundimin e studimeve master ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ka dorëzuar si dëshmi vetëm Formularin për mbrojtjen e punimit të diplomës master, të datës 04.03.2022, ndërsa me von gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës ankuesja ka dorëzuar si dëshmi edhe Raportin për verifikimin e të dhënave të aplikuesit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimin me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

Kolegji vlerëson se Formulari për mbrojtjen e punimit të diplomës master, i datës 04.03.2022, i dorëzuara nga ankuesja me rastin e aplikimit, mund të shërbejë si dëshmi për nevojat e brendshme të Fakultetit, gjegjësisht Universitetit, por jo edhe për nevojat e punësimit, sepse me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, përkatësisht nën 135 përcaktohet se: *Përfundimi i suksesshëm i studimeve në përputhje me programin e studimeve vërtetohet nga Universiteti përmes diplomës që është dokument zyrtar.*

Ankuesja me rastin e parashtrimit të ankesës është referuar edhe dy dokumenteve tjera si Raportin për verifikimin e të dhënave të aplikuesit Nr.2718 të datës 08.04.2022 dhe Vërtetimit me numër ref.nr.12/1595 të datës 12.04.2022 të lëshuar nga Fakulteti Ekonomik pranë Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", dhe pretendon se këto dokumente kanë qenë dëshmi të mjaftueshme përmes të cilave vërtetohet përfundimi i studimeve master, mirëpo Kolegji ka gjetur se të dy këto dokumente të cilave ju referohet ankuesja mbajnë datën e lëshimit 08.04.2022 gjegjësisht 12.04.2022, pas datës së fundit të mbylljes së konkursit që ishte data 06.04.2022, ndërsa me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës përkatësisht nën 10 paragrafi 2 përcaktohet se: *2. Të gjitha shpalljet e konkurimit, gjithashtu, përmbajnë këto shënime: 2.2 Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.*

Andaj, bazuar si më sipër Kolegji vlerëson se ankuesja me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 29.03.2022 deri me datë 06.04.2022 nuk ka sjellur dëshmi të duhura për vërtetimin e përfundimit të studimeve master, nga autoriteti kompetent, në këtë rast Universiteti i Prishtinës, dhe në këtë mënyrë nuk ka plotësuar kriterin e konkursit lidhur me arsimimin, ku përcaktohet: *Arsimi i kërkuar: Diploma e studimeve universitare në Fakultetin Ekonomik, Financa dhe Kontabilitet me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. Diploma Master të jetë e njëjta apo vazhdim i diplomës Bachelor.* Në këtë kuptim Kolegji konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të paqëndrueshme dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerzore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.02/2022 të datës 13.04.2022 për refuzimin e aplikacionit të ankueses dhe Vendimin me numër 10/2022 të datës 21.04.2022 për refuzimin e ankesës si të pa bazuar ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike dhe

rrjedhimisht drejte ka zbatuar ligjin material, duke vepruar keshtu ne perputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 per Zyrtaret Publikë, dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.426/2022, datë 10.06.2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet;

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Thesarin e Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

